



FEDERATA E BADMINTONIT E KOSOVËS

BADMINTON SAVEZ KOSOVO

BADMINTON FEDERATION OF KOSOVO

Tel&Fax+ 383 132 917 +383-44-211-434;

Shtëpia e sporteve Rr. "Agim Ramadani" pn, 10000 Prishtinë

www.badminton-rks.org, email: b.f.kosovo@gmail.com

STATUTI

2025

Në përputhje me nenin 19.20.29 të Ligjit Nr. 08/ L-277 për Sport, në bazë të nenit 20 të Ligjit Nr. 06/L- 043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare të plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 08/L-244, Ligjin Nr. 05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive, në harmoni me Statutin e Komitetit Olimpik të Kosovës, Federatës Botërore të Badmintonit BWF, Kuvendi në mbledhjen e datës: 26.03.2025, miratoi këtë:

STATUT

Kapitulli I – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Emri

1. Federata e Badmintonit e Republikës së Kosovës, është asociacion vullnetar i shoqatave-klubeve dhe organizatave të cilat për veprimtari themelore kanë sportin e Badmintonit.
2. Emri i federatës është: **FEDERATA E BADMINTONIT E KOSOVËS -BADMINTON SAVEZ KOSOVO- BADMINTON FEDERATION OF KOSOVO**

2.1. Ajo mund të njihet edhe me akronimin si **B.F.K**

3. Federata e ka logon, vulën dhe flamurin e vet. Logoja është e përbërë prej gjashtë yjeve, në mes të sajë është e vendosur flutur e rrethuar me ngjyrë të arit. Nën yje ka dy vija harkore në mes të së cilës janë të shënuara inicialet apo shkurtesa e B.F.K. Logoja e Federatës është e mbrojtur dhe mund të përdoret vetëm me lejen e Bordit të Federatës së badmintonit të Kosovës.
4. Flamuri i Federatës ka formën e njëjtë sikurse logoja
5. Federata e badmintonit e Kosovës është themeluar më 27.04.2018 dhe prej vitit 2019 është anëtare e Federatës Botërore të Badmintonit (BWF) dhe e Federatës Europiane të Badmintonit (BEC). Federata e badmintonit e Kosovës është anëtare e Komitetit Olimpik të Kosovës, si dhe njohur nga Ministria për Kulturë dhe Sport nga viti 2019
6. Organizata është shoqatë jofitimprurëse, sipas definimit të dhënë në nenin 16 dhe 20 të Ligjit Nr.06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.



Neni 2

Përbërja

1. Federata e Badmintonit e Kosovës përbëhet nga klubet e badmintonit (në tekstin e mëtejme: ANËTAR) për të udhëhequr sportin e badmintonit në territorin e Kosovës në përputhje dhe Statutin e Federatës së badmintonit të Kosovës .
2. Federata e badmintonit e Kosovës duke u njohur si e tillë nga Departamenti për Regjistrim të OJQ (Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike), Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport të Republikës së Kosovës (të referuar në tekstin e mëtejme me akronimin: MKRS), Komiteti Olimpik i Kosovës (të referuar në tekstin e mëtejme me akronimin: KOK), Balkan Badminton Association (të referuar në tekstin e mëtejme BBA, Federata evropiane e badmintonit (të referuar në tekstin e mëtejme me akronimin: BEC), Federata botërore e badmintonit (të referuar në tekstin e mëtejme me akronimin: BWF) e ka autoritetin e vetëm në territorin Kosovës për të gjitha çështjet në lidhje me sportin e badmintonit.
3. Federata e badmintonit e Kosovës e ka juridiksionin e vetëm për organizimin e një ngjarje të badmintonit duke përdorur emërtimin ose titullin 'Kosova', ose të ngjashme, ose autorizon organizimin e një ngjarje të tillë.

Neni 3

Parimet

1. Sporti për të gjithë – përfshinë unitetin e përgjithshëm të veprimit, respektimin e ndërsjellë të anëtarëve dhe papranueshmërinë e diskriminimit ndaj anëtarëve ose individëve në bazë racore, politike, fetare, gjinore ose në baza tjera.
2. Ligjshmëria - veprimet duhet të jenë në përputhje me dispozitat e këtij statuti, dhe Ligjin përkatës për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Tjera Negative në Ngjarjet Sportive, Ligjin përkatës për Sport, Ligjin përkatës për Sponsorizimin në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit si dhe legjislacionin përkatës sekondar që derivojnë nga këto ligje.
3. Qeverisja e mirë - BFK-ja respekton parimet e përgjithshme dhe themelore të Qeverisjes së Mirë, Kodin e Etikës të BWF; Kodi i Lëvizjes Olimpikë për Parandalimin e Manipulimit të Garave, Kodi Mjekësor të Lëvizjes Olimpikë, Rregullat Anti-Doping të BWF, Manualin e Komisionit Ndërkombëtar Paraolimpik (IPC)
4. Mosdiskriminimi dhe Ambienti i sigurt – Federata e badmintonit e Kosovës angazhohet të sigurojë një ambient pune dhe sportiv në të cilin të gjithë individët trajtohen me respekt, dinjitet dhe pa ngacmim. Çdo individ ka të drejtë të marrë pjesë dhe të punojë në një mjedis i cili promovon mundësi të barabarta dhe ndalon praktikat diskriminuese.
5. Transparenca - veprimet e BFK-së janë transparente dhe dokumentet publike duhet të jenë të qasshme në përputhje me ligjin përkatës për qasjen në dokumente publike;
6. Mbrojtja e privatësisë–veprimet nuk cenojnë privatësinë dhe të dhënat personale të personave

të përfshirë në aktivitet sportiv mbrohen në përputhje me ligjin përkatës;

7. Mbrojtja e fëmijëve dhe të rinjve— ndërmarrja e të gjitha masave mbrojtëse për fëmijët dhe të rinjtë pjesëmarrës në sport, në të cilat përfshihen njoftimi i policisë, organit të kujdestarisë dhe organeve të tjera shtetërore përkatëse për çdo lloj dhune ndaj tyre, keqpërdorim, ngacmim ose sjellje tjetër të pahijshme;
8. Mbrojtja e mjedisit dhe siguria publike - Federata e badmintonit e Kosovës angazhohet të marrë një qasje të përgjegjshme për mbrojtjen e mjedisit dhe administrimin e burimeve përmes praktikave të saja në organizimin e ngjarjeve dhe në administrimin e aktiviteteve të saja.
9. Fair-play – sporti zhvillohet në bazë të rregullave, konkurrencës së ndershme, respektit ndaj kundërshtarit, parandalimit dhe shmangies së dhunës dhe sjelljes jo të drejtë,

Neni 4

Qëllimet dhe Objektivat

1. Qëllimi i Federatës së Badmintonit të Kosovës është: masivizimi, zhvillimi kualitativ dhe organizimi i Badmintonit, në ngritjen e cilësisë me të gjitha grup moshat deri në nivelin elitë.
 - 1.1. Zhvillimi i frymës së miqësisë dhe ndihmës së ndërsjellë midis anëtarëve, zyrtarëve, trajnerëve dhe lojtarëve;
 - 1.2. Përmirësimi i vazhdueshëm në standardin teknik të badmintonit dhe promovimi i pjesëmarrjes së badmintonit në mbarë Kosovën.
 - 1.3. Nxitja e konkurrencës miqësore sportive dhe eliminimi i praktikave të padrejta dhe jopërkrahëse si kurdishja e ndeshjeve, korrupsionit në ndeshje, bastet e parregullta dhe të paligjshme, doping ose pajisje të paligjshme;
 - 1.4. Zbatimi Statutit dhe akteve normative në fuqi, duke marrë në konsideratë Rregulloret e ITTO (Instruksions to Technical Officiels) për Garat Ndërkombëtare, Rregullat Anti-Doping të BWF, Kodin e Etikës të BWF, Politikën dhe Procedurat Kundër Ngacmimit të BWF dhe rregulloret e tjera të Federatës së badmintonit të Kosovës;
 - 1.5. Promovimi, organizimi dhe mbikëqyrja e garave dhe aktiviteteve të Federatës së badmintonit të Kosovës ;
 - 1.6. Përdorimi i fondeve të Federatës së badmintonit të Kosovës në realizimin e objektivave të Federatës.
 - 1.7. Masovizimi i pjesëmarrjes në të gjitha nivelet, rritja e popullaritetit të badmintonit, kërkimi dhe sigurimi i burimeve të reja të të ardhurave dhe menaxhimi i badmintonit në përputhje me planin strategjik të Federatës së badmintonit të Kosovës ;
 - 1.8. Inkurajimi i lojtarëve, trajnerëve dhe zyrtarëve që ta paraqesin badmintonin pozitivisht në mënyrat më të mira për të përmirësuar imazhin e tij;

- 1.9. Mbështetja për realizimin e programeve publike të badmintonit;
 - 1.10. Përcaktimi i politikës për mbrojtjen e cilësisë kulmore/ të lartë të sportistëve;
 - 1.11. Mbështetja e punës profesionale dhe aftësimi i personelit profesional të badmintonit;
 - 1.12. Mbështetja për kushtet e përgatitjeve të sportistëve kulmor për Lojrat Olimpike, Kampionatet Evropiane dhe Botërore dhe garat tjera ndërkombëtare;
 - 1.13. Përcaktimi dhe zbatimi i politikave zhvillimore të sportit të Badmintonit.
 - 1.14. Ushtrime të rregullta të badmintonit për të gjitha grupmoshat në dy gjinitë.
 - 1.15. Mbështetja zhvillimit të badmintonit në vendet rurale
2. Zbatimi i qëllimeve dhe veprimtarive të Federatës së badmintonit të Kosovës bëhet përmes aktiviteteve në përputhje me planin strategjik të zhvillimit dhe programet zhvillimore të aprovuara nga Bordi Ekzekutiv dhe Kuvendi dhe aktiviteteve në vijim:
 - 2.1. Duke organizuar paraqitjen e Përfaqësueseve të badmintonit;
 - 2.2. Duke organizuar gara në Kosovë, veçmas Kampionatet vendore dhe garat sportive ndërkombëtare ku marrin pjesë Përfaqësueset tona;
 - 2.3. Duke rritur numrin e badmintonistëve dhe të klubeve;
 - 2.4. Duke organizuar seminare për trajnerë dhe kurse për aftësimin e administratorëve;
 - 2.5. Duke botuar revista profesionale elektronike e duke përdorur rrjetet elektronike sociale, që zhvillojnë një mënyrë më të përsosur të propagandës dhe marketingut për badmintonin Kosovar;
 - 2.6. Duke marrë pjesë në aktivitetet e KOK-ut;
 - 2.7. Duke ndarë shpërblime dhe mirënjohje nga Federata e badmintonit të Kosovës;
 - 2.8. Duke dërguar shpresat tona dhe garuesit e rinjë dhe më përspektivë në qendrat e njohura ndërkombëtare në përgatitje dhe trajnime speciale;
 - 2.9. Duke organizuar kampe stërvitore vendore me ekspertë të njohur botërorë;
 - 2.10. Duke intensifikuar bashkëpunimin me Federatat e tjera nga rajoni me qëllim të shkëmbimit të përvojave organizative dhe profesionale;
 - 2.11. Duke përparuar punën e Komisionit të trajnerëve dhe gjyqtarëve;
 - 2.12. Duke kryer edhe punë tjera të përcaktuara me Ligjin për Sport, benefitet e Ligjit për Sponsorizimin Sportiv dhe aktet tjera normative.

Neni 5

Statusi juridik

1. Federata e Badmintonit e Kosovës është e regjistruar në Ministrinë përkatëse për Administratë Publike, Departamenti për OJQ në Prishtinë, Kosovë si një OJQ sportive jo-fitimprurëse, sipas Ligjit nr 04/L-57 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare të datës 24/04/2019.
2. Selia e Federatës së badmintonit të Kosovës është në Prishtinë, në Shtëpinë e Sporteve, rr. Agim Ramadani, Pn. 60000 Prishtinë.
3. Federata nuk do të bëjë shpërndarjen e çfarëdo të ardhure neto ose fitimi si të tillë për asnjë person. Pasuria, të ardhurat dhe fitimet e organizatës do të përdoren për të mbështetur qëllimet jofitimprurëse të organizatës dhe nuk do të përdoren për të krijuar përfitime të veçanta individuale, qoftë në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo tërthorazi për asnjërin nga themeluesit, drejtorin, nëpunësit, ndonjë anëtar të shoqatës, ndonjë të punësuar apo donator të Federatës së badmintonit të Kosovës. Megjithatë pagesa e kompensimit të arsyeshëm për këta persona mund të bëhet për punën që këta persona bëjnë për këtë organizatë.
4. Çdo transaksion ndërmjet Federatës së badmintonit të Kosovës dhe një organizate tjetër të ndërlidhur, apo ndërmjet Federatës së badmintonit të Kosovës dhe anëtarëve, zyrtarëve, anëtarëve të bordit ose punonjësve të saj ndalohej, përveç, nëse organi drejtues vendos, pas hetimeve të arsyeshme, se transaksioni është në interes, i drejtë dhe i arsyeshëm për Federatën e badmintonit të Kosovës, dhe se Federata e badmintonit e Kosovës nuk kishte mundur të sigurojë marrëveshje më të favorshme me përpjekje të arsyeshme dhe brenda rrethanave ekzistuese.
5. Organizata mund të angazhohet në aktivitete ekonomike me qëllim të mbështetjes së aktiviteteve të saja jofitimprurëse, në pajtim me nenin 1 paragrafin 6 të këtij Statuti dhe nenin 35 të Ligjit për Lirim të Asociimit në OJQ Nr.06/L-043, me kusht që të ardhurat e realizuara nëpërmjet të aktiviteteve ekonomike të shfrytëzohen ekskluzivisht për të arritur qëllimet e theksuara në këtë statut.
6. Numri minimal i anëtarëve (Klubeve sportive) në anëtarësi do të jetë pesë (5) të cilët veprojnë në së paku tri (3) qytete të ndryshme të Kosovës.

Neni 6

Baza e Vizionit, Misionit dhe Planit Strategjik

1. Baza e vizionit të Federatës së badmintonit të Kosovës është badminton për të gjithë gjatë tërë jetës dhe badminton elitare.
2. Baza e misionit të Federatës së badmintonit të Kosovës është promovimi në mënyrë aktive i badmintonit në Kosovë duke krijuar një piramidë të zhvillimit e cila është e vazhdueshme, progresive e strukturuar dhe garuese për lojtarët, trajnerët, administratorët dhe zyrtarët e garave, nga niveli fillestar deri në Lojëra Olimpike.

3. Qeverisja profesionale dhe zhvillimore e Federatës së badmintonit të Kosovës bazohet në planin strategjik 4 vjeçar të Federatës së badmintonit të Kosovës në përputhje me ciklin olimpik, i cili udhëhiqet nga promovimi i vlerave si: Pasioni, Rivaliteti, Integriteti, Respekti, Disiplina, Krenaria, Inovacioni, Ekselencia, Profesionalizmi, Komunkimi dhe Transparenca.

Kapitulli II - ANËTARËSIA

Neni 7

Pranueshmëria

1. Anëtar të Federates së badmintonit të Kosovës, janë vetëm klubet sportive të badmintonit të cilat në baza vjetore regjistrohen me sukses sipas kriterëve të përcaktuara në Rregulloren përkatëse të Federatës së badmintonit të Kosovës për regjistrimin e klubeve dhe anëtarëve, si dhe pas miratimit nga Kuvendi siç përcaktohet në nenin 8 paragrafi 4 të këtij Statuti.
2. Anëtarësia në Federatën e badmintonit të Kosovës është e hapur për çdo klub të badmintonit që vepron në territorin e Kosovës dhe e që:
 - 2.1. është e regjistruar në Ministrinë e Administratës Publike, Departamenti për OJQ në Prishtinë, Kosovë si një OJQ sportive dhe posedon certifikatën zyrtare të lëshuar nga ky institucion
 - 2.2. apo si shoqëri tregtare e regjistruar në ARBK në ministrinë përkatëse sipas nenit 21 pika 2 e ligjit të sportit nr 08/L-277,
 - 2.3. është e regjistruar në Drejtorinë e Sportit pranë Kuvendit Komunal në qytetin përkatës ku vepron dhe posedon një vendim të tillë nga organet kompetente komunale
 - 2.4. një klub nuk mund të ketë statusi e organizatës joqeveritare dhe të shoqërisë tregtare njëkohësisht.
3. Rregullat e punës, konstituimit dhe funksionimit të anëtarëve duhet të jenë në harmoni me dispozitat e këtij Statuti, Ligjit të Sportit dhe Ligjit për OJQ, dhe ligjit për shoqëritë tregtare si dhe të njejtë janë përgjegjës për zbatimin e vendimet të organeve të Federatës së badmintonit të Kosovës.

Neni 8

Aplikimi dhe zgjedhja

1. Aplikimi i anëtarëve për regjistrim të bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në Rregulloren përkatëse të Federatës së badmintonit të Kosovës për regjistrimin., e cila Rregullore do miratohet nga Kuvendi i Anëtarëve të Federates së badmintonit të Kosovës dhe do të jetë në harmoni të plotë me këtë statut, Ligjin për OJQ dhe Ligjin për Sport .

2. Bordi Ekzekutiv rishikon raportin e komisionit për regjistrim për të gjitha aplikimet për anëtarësi dhe do i rekomandon për pranim në Mbledhjen e Rregullt ose të Jashtëzakonshme të Kuvendin të Anëtarëve, por kryesisht në Mbledhje të rregullt të punës para fillimit të sezonit garues kalendarik.
3. Për anëtarët ekzistues aktiv, Bordi Ekzekutiv sipas raportit të komisionit për regjistrim e bënë konfirmimin e anëtarësisë. Ndërsa për anëtarët e rinj dhe anëtarët të cilët nuk e kanë paraqitur kërkesën për ripërtirjen e regjistrimit, Bordi Ekzekutiv sipas raportit të komisionit për regjistrim i paraqet rekomandimet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.
4. Kuvendi me shumicën e votave të anëtarëve prezent me të drejtë vote merr vendim për rekomandime të Bordit Ekzekutiv për anëtarësim/regjistrime.

Neni 9

Pezullimi dhe ndërprerja e anëtarësimit

1. Një Anëtar që dëshiron të ndërprejë anëtarësinë nga Federata e badmintonit të Kosovës do të njoftojë me shkrim Sekretarin e Përgjithshëm të Federatës së badmintonit të Kosovës . Ndërprerja mund të hyjë në fuqi në çdo kohë nga marrja e një njoftimi të tillë deri më 31 Dhjetor të të njëjtit vit, por anëtari është i obliguar për kthimin e borxheve eventuale apo asetëve në përdorim më së largu 30 ditë nga momenti kur i është ndërprerë anëtarësimi në Federatën e Badmintonit të Kosovës. Kërkesa me shkrim për ndërprerje duhet të paraqesë arsyetimin, kohën e propozuar si dhe të gjitha përpjekjet që kanë bërë për ruajtjen e anëtarësisë. Anëtari dhe Federata e badmintonit të Kosovës së pari do të jenë të angazhuar në diskutime të drejtpërdrejta ose të ndërmjetësuara me qëllim të mbajtjes dhe ruajtjes së anëtarësisë.
2. Një Anëtar i cili për ndonjë arsyetim të pranuar nga Kuvendi iu janë dhënë afate për shtyrjen e pagesës së anëtarësisë dhe i cili nuk ka kthyer pagesat apo borxhet e mbetura ndaj Federatës së badmintonit të Kosovës sipas afatit të caktuar nga Kuvendi do të pezullohet automatikisht nga e drejta e votës dhe pjesëmarrjes në gara ekipore.
3. Një Anëtar i cili shkel Statutin, aktet normative dhe vendimet e Federatës së badmintonit të Kosovës, ndaj tij do të inicohet rasti në komisionin disiplinor sipas akteve normative të Federatës së badmintonit të Kosovës .
4. Anëtarësimi formal në Federatën e badmintonit të Kosovës ndërpritet si në vijim:
 - 4.1. Me fshirjen nga regjistri i Anëtarëve aktual;
 - 4.2. Nëse vërtetohet se Anëtari ka pushuar së vepruari;
 - 4.3. Nëse nuk ka mbajtur Kuvendin së paku një herë në vit;
 - 4.4. Me vendimin e Kuvendit të Federatës së badmintonit të Kosovës siç përcaktohet në nenin 8 paragrafi 4 të këtij Statuti;
 - 4.5. Me kërkesën personale me arsyetimin me shkrim,

Neni 10

Të drejtat e anëtarëve

1. Anëtarët kanë këto të drejta:

- 1.1. Të emrojnë tre (3) përfaqësues i (të thirrur si delegatë) për të marrë pjesë në Mbledhjet e Kuvendit të Anëtarëve;
- 1.2. Të paraqesë propozime për përfshirje në agjendën e Kuvendit;
- 1.3. Të emrojnë kandidatët për zgjedhje ose emërim në kuadër të organeve të Federatës së Badmintonit të Kosovës;
- 1.4. Të paraqesin lojtarët për pjesëmarrje në garat e organizuara nga Federata e badmintonit e Kosovës sipas rregullave specifike kualifikimit të secilës ngjarje apo thirrje nga Federata e badmintonit e Kosovës;
- 1.5. Për të marrë pjesë dhe përfituar nga ndihma, zhvillimi dhe programet zhvillimore të Federatës së badmintonit të Kosovës;
- 1.6. Për të ushtruar të gjitha të drejtat e tjera që rrjedhin nga Statuti ose aktet tjera normative të Federatës së Badmintonit të Kosovës;

Neni 11

Detyrimet e anëtarëve

1. Anëtarët kanë këto DETYRIME:

- 1.1. Të respektojnë Statutin dhe aktet normative të Federatës së badmintonit të Kosovës ;
- 1.2. Të njoftojë menjëherë Federatën e badmintonit të Kosovës për çdo ndryshim në kryesi;
- 1.3. Të kërkojnë nga të gjithë anëtarët e tyre të klubit që të respektojnë Statutin dhe akteve normative të Federatës së badmintonit të Kosovës ;
- 1.4. Të jetë përgjegjës për klubin, lojtarët dhe zyrtarët e tyre, përfshirë kryerjen e pagesave të anëtarësisë, gjobat dhe pranueshmërinë, në përputhje me Statutin dhe aktet normative të Federatës së badmintonit të Kosovës ;
- 1.5. Të mbajnë kuvendet e rregullta vjetore në klubet e tyre ndërsa kuvendet zgjedhore t'i mbajnë në vitin e njëjtë kalendarik kur Federata e badmintonit e Kosovës organizon Kuvendin zgjedhor dhe obligohen të njoftojnë Bordin Ekzekutiv dhe për vendin dhe kohën e mbajtjes;
- 1.6. të përmbush çdo herë kriteret për anëtarësim.

Kapitulli III - BASHKËPUNIMI DHE GRUPIMI I ANËTARËVE

Neni 12

Grupimet tjera të anëtarëve

1. Grupimi i Anëtarëve mund të lejohet nga Federata e badmintonit e Kosovës dhe organizohet duke përfshirë, në parim, Anëtarët që ndajnë objektiva të përbashkëta (promovimi i badmintonit në cilindo prej formave ose kategorive të tij, organizimi i kampeve e garave për tituj specifikë ose për fushat e bashkuara nga gjuha, historia dhe / ose kultura), përmes një kërkesë specifike drejtuar dhe miratuar në parim nga Bordi Ekzekutiv dhe pas miratimit në Kuvend.
2. Çdo grupim i Anëtarëve i aprovuar nga Kuvendi i Federatës së badmintonit të Kosovës ka të drejtë të organizojë ngjarje specifike për të gjithë Anëtarët e grupimit, me kusht që Statuti dhe aktet normative të Federatës së badmintonit të Kosovës të respektohen në tërësi dhe të njejtat ngjarje mos të bien ndesh me kalendarin e Federatës së badmintonit të Kosovës .
3. Puna e Grupeve të Anëtarëve rregullohet me rregullore të veçantë që do jetë në harmoni me këtë statut dhe Ligjin për OJQ dhe Sport.

Neni 13

Pozitat e nderit

1. Sipas shpalljes së hapur publike, me rekomandimin e Bordit Ekzekutiv, Kuvendi mund të emërojë si “Anëtar Nderi” çdo dy vite një person që ka dhënë shërbime të jashtëzakonshme dhe meritore për Federatën e badmintonit të Kosovës
2. Një Anëtar Nderi ka të drejtë të marrë mikpritjen falas në të gjitha ngjarjet e organizuara nga Federata e badmintonit të Kosovës dhe të marrë pjesë e të marrë fjalën në Kuvend por pa të drejtë vote.
3. Sipas shpalljes së hapur publike, me rekomandimin e Bordit Ekzekutiv, Kuvendi mund të jap titullin “Simbol i Nderit” një personi që ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në punën e Federatës së badmintonit të Kosovës dhe / ose për Objektivat e tij.
4. Me rekomandimin e Bordit Ekzekutiv, Kuvendi mund të revokojë një pozicion nderi.

Kapitulli IV - QEVERISJA

Neni 14

Organet e Federatës së badmintonit të Kosovës

1. Federata e badmintonit e Kosovës e ushtron veprimtarinë e saj përmes organeve drejtuese të krijuara me këtë Statut.
2. Organet drejtuese të Federatës së badmintonit të Kosovës janë:
 - 2.1 Kuvendi,
 - 2.2 Bordi Ekzekutiv,
 - 2.3 Komisioni mbikqyrës,
 - 2.4 Komisioni diciplinor
 - 2.5 Bordi i Apelit (mekanizmi për shqyrtimin e ankesave)
 - 2.6 Komisioni për përfaqësimin e sportistëve

Neni 15

Kuvendi

- 3 Kuvendi është organi më i lartë i Federatës i cili përbëhet prej anëtarëve të autorizuar të klubeve të Federatës.
- 4 Kuvendi ka kompetencat si në vijim:
 - 4.1 Miratimin e Statutit, Rregulloreve dhe Vendimeve të Federatës së badmintonit të Kosovës
 - 4.2 Miraton planin Strategjik dhe propozimet e programit të përgjithshëm të sportit të Badmintonit;
 - 4.3 Zgjedhë Kryetarin e Federatës së badmintonit të Kosovës, në një Kuvend të mbajtur zgjedhor në vitin e njëjtë kalendarik pas përfundimit të Lojërave Olimpikë Verore. Kryetari i zgjedhur do të shërbejë për një mandat katër (4) vjeçar dhe do të ketë të drejtë për rizgjedhje edhe (dy) mandate të njëpasnjëshëm në të njëjtin funksion.
 - 4.4 Zgjedhë shtatë (7) anëtarë të Bordit Ekzekutiv të Federatës së badmintonit të Kosovës. Të gjithë anëtarët e zgjedhur do të shërbejnë për një mandat katër (4) vjeçar dhe do të kenë të drejtë për rizgjedhje edhe (dy) mandate të njëpasnjëshëm në të njëjtin funksion;
 - 4.5 Zgjedhë tre (3) anëtarë të komisionit të Apelit për një mandat katër (4) vjeçar të cilët të

- kenë të drejtë për rizgjedhje edhe një mandat të njëpasnjëshëm në të njëjtin funksion;
- 4.6 Zgjedhë tre (3) anëtarë të Komisionit Mbikqyrës për një mandat katër (4) vjeçar të cilët do të kenë të drejtë për rizgjedhje edhe një mandat të njëpasnjëshëm në të njëjtin funksion;
- 4.7 Zgjedhë tre (3) anëtarë të Komisioni Disiplinor për një mandat katër (4) vjeçar të cilët do të kenë të drejtë për rizgjedhje edhe një mandat të njëpasnjëshëm në të njëjtin funksion;
- 4.8 Miraton punën e bërë nga Bordi Ekzekutiv që nga Kuvendi i fundit;
- 4.9 Kryen zgjedhjet dhe emërimet e poashtu edhe shkarkimet, në pajtim me Statutin;
- 4.10 Miraton dokumentet dhe raportet vjetore të Kryetarit dhe Bordit Ekzekutiv duke përfshirë raportin e punës, raportin financiar, draft propozim buxhetin, kalendarin e garave si dhe raportet e rekomandimit të Bordit Ekzekutiv;
- 4.11 Miraton apo pezullon anëtarësinë e klubeve të badmintonit.
- 5 Përfaqësimi i anëtarëve dhe pjesëmarrja në Mbledhje të Kuvendit është si në vijim:
- 5.1 Çdo Anëtar e ka të drejtën e emërimit të tre (3) delegatëve në Kuvend;
- 5.2 Anëtari mund të delegoj personin për Mbledhje të Kuvendit personat që:
- 5.2.1 Janë shtetas të Kosovës,;
- 5.2.2 I kanë mbushur 18 (tetëmbëdhjetë) vjet dhe janë të aftë për punë;
- 5.2.3 të jenë anëtar të organizatës që përfaqëson,
- 5.2.4 të jenë veprimtar ose sportist dhe nuk që nuk janë të gjykuar dhe nuk ka rënë në kundërshtim me normat etike dhe parimet e Lëvizjes Olimpike.
- 5.3 Anëtarët e Bordit Ekzekutiv, Anëtarët e Nderit dhe Sekretari i Përgjithshëm i Federatës së badmintonit të Kosovës , u lejohej të marrin pjesë në Kuvend me të drejtë të flasin, por jo të votojnë përveq nëse të njëjtit nuk janë delegatë në Kuvend. Anëtarët e Komisioneve të Federatës së badmintonit të Kosovës kanë të drejtë të marrin pjesë në Kuvend si vëzhgues, pa privilegje për të folur ose votuar, përveq nëse të njëjtit nuk janë delegatë në Kuvend.
- 5.4 Udhëheqësi i Kuvendit, në mënyrë të jashtëzakonshme, mund të lejojë pjesëmarrjen e të ftuarve specialë dhe të flasin në Kuvend.
- 6 Mbledhja e Kuvendit mbahet nëse verifikohet se ekziston një kuorum prej më shumë se gjysma (1/2) e delegatëve që përfaqësojnë Anëtarët, e që jenë të pranishëm me të drejtë përfaqësimi dhe me të drejtë vote.
- 7 Mbledhjet e Kuvendit mund të jenë të: rregullta, jashtëzakonshme, solemne dhe zgjedhore. Kuvendi mblidhet së paku një herë në vit.

- 8 Në çdo katër vjet mbahet Kuvendi zgjedhor.
- 9 Mbledhjet e rregullta, zgjedhore dhe solemne i thërret Kryetari i Federatës. Njoftimi për vendin dhe kohën e takimit të Kuvendit dërgohet jo më vonë se pesëmbdhjetë (15) ditë përpara datës së mbledhjes, ndërsa dokumentet, raportet dhe materialet përcjellëse dërgohen jo më vonë se një (1) javë përpara datës së mbledhjes së Kuvendit.
- 10 Detajet me shkrim të propozimeve që do të trajtohen në Mbledhjet të Kuvendit e radhës dërgohen tek Sekretari i Përgjithshëm jo më vonë se tetë (8) ditë përpara datës së mbledhjes.
- 11 Afati i fundit për nominimet dhe emërimet për zgjedhje do të dërgohen jo më vonë se tetë (8) ditë përpara datës së zgjedhjes përkatëse në Kuvend.
- 12 Çdo Anëtar i regjistruar në Federatën e badmintonit të Kosovës me certifikatë përkatëse të OJQ-së ose ARBK-së dhe i cili ka përfunduar garat ekipore në vitin paraprak me ekipin bazë që e ka përcaktuar në fillim të vitit (i përfaqësuar përmes delegatëve të emëruar në Kuvend) e ka të drejtën e tri (3) votave në Kuvend..
- 13 Votimi mund të inicohet nëse verifikohet prezenca e shumicës së delegatëve 50% +1 me të drejtë vote.
- 14 Për tu zgjedhur në cilëndo pozitë të organeve të Federatës së badmintonit të Kosovës, një kandidat duhet të marrë shumicën e thjeshtë të votave PËR nga delegatët e pranishëm me të drejtë vote.
- 15 Vendimet në Kuvend miratohen me shumicë të votave të hedhura PËR nga delegatët me të drejtëvotë, përveç në rastet specifike në vijim:
- 15.1 për ndryshimet në Statut, nevojitet së paku dy të tretat (2/3) e votave të delegatëve me të drejtëvotë prezent në Kuvend.
- 15.2 për shpërbërjen e Federatës së badmintonit të Kosovës, nevojitet së paku katër të pestave (4/5) të votave të delegatëve me të drejtë vote prezent në Kuvend;
- 16 Votat e hedhura janë votat PËR dhe votat KUNDËR. Abstenimi llogaritet votë kundër në përputhje me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Votat e pavlefshme nuk llogariten si vota të hedhura.
- 17 Nëse ka rezultat të barabart të votave për çdo çështje vota e udhëheqësit të Kuvendit është përcaktuese.
- 18 Votimi, përveç në zgjedhje, do të bëhet me një ngritje dore apo me pajisje elektronike ose me votim të fshehtë, siç vendoset nga Kuvendi me një propozim nga Udhëheqësi i Kuvendit;
- 19 Në rastet e votimit të fshehtë, tre (3) delegatë do të emërohen, për miratim nga Kuvendi, për të vepruar në cilësinë e komisionit verifikues;
- 20 Komisioni verifikues është përgjegjës për organizimin e saktë të votimit dhe fletëvotimit,

sigurimin e kutisë votuese transparente dhe të sigurtë, përfshirë shpërndarjen e fletëve të votimit, numërimin e votave të hedhura në prezencë të delegatëve dhe shpalljen e rezultatit të votimit.

21 Votimi në zgjedhje bëhet me votim të fshehtë. Nëse ka vetëm një kandidat për një post, Kuvendi mund të vendosë me aklamacion, përveç nëse një delegat kërkon një votim të fshehtë. Me shumicën e votave të delegatëve në Kuvend, votimi në zgjedhje mund të bëhet i hapur.

22 Një Mbledhje e jashtëzakonshme e Kuvendit mund të thirret nga Bordi Ekzekutiv ose mund të thirret brenda tre (3) javësh nga data e pranimit nga Sekretari i Përgjithshëm i një kërkesë me shkrim të paraqitur dhe të nënshkruar nga jo më pak se një e treta (1/3) e Anëtarëve me të drejtë vote, pasi që të verifikohet lista e nënshkrimeve të 1/3 të përfaqësuesve të autorizuar të klubeve nga administrata e FPPK-së

23 Njoftimi për mbajtjen e Mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit duhet tu dërgohet të gjithë Anëtarëve jo më vonë se shtatë (7) ditë përpara datës së mbledhjes.

24 Kërkesa për një Mbledhje të Kuvendit të jashtëzakonshme përcakton çështjen që do të trajtohet.

25 Mbledhjet e Kuvendit organizohen dhe mbahen në pajtim me dispozitat e Rregullores për punën e Kuvendit.

24. Me Rregulloren e punës së Kuvendit më detalisht përcaktohet mënyra e punës në mbledhje dhe në organet e saj, të drejtat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Kuvendit dhe çështjet tjera me rëndësi për punën në Kuvend.

Neni 16

Bordi Ekzekutiv

1. Bordi Ekzekutiv është organ drejtues dhe ekzekutiv i Federatës së badmintonit të Kosovës .
2. Bordi Ekzekutiv ka këto detyra dhe përgjegjësi:
 - 2.1. Vendos për anëtarësimin e Federatës së badmintonit të Kosovës në organizatat tjera sportive si dhe lidhë marrëveshje bashkëpunimi;
 - 2.2. Përcakton aktivitetet dhe procedurat e brendshme;
 - 2.3. Emëron Sekretarin e Përgjithshëm të Federatës së badmintonit të Kosovës dhe emëron personelin tjetër administrativ të angazhuar sipas nevojës;
 - 2.4. Emëron Drejtorin e Përfaqësueses të Federatës së badmintonit të Kosovës ;
 - 2.5. Emëron kryesuesit dhe anëtarët e Komisioneve, Zyrtarët dhe grupet e punës, përveç Komisionit të Sportistëve të cilët zgjedhen nga votimi i sportistëve;
 - 2.6. Përcakton detyrat dhe obligimet, nëse nuk janë të përcaktuara në aktet normative përkatëse, për të gjitha Komisionet ekzistuese ose ato të reja që Bordi Ekzekutiv mund ti krijojë

herë pas here;

2.7. Harton planin strategjik të Federatës së badmintonit të Kosovës për një cikël Olimpik dhe të njejtin i'a paraqet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim;

2.8. Cakton llogarinë bankare të Federatës së badmintonit të Kosovës dhe autorizon personat me nënshkrim në to;

2.9. Të propozoj buxhetin për miratim nga Kuvendi;

2.10. Shqyrton të gjitha aplikimet për anëtarësim të ri bazuar në raportin e komisionit për regjistrim dhe të bëjë rekomandime për pranimin e tyre në Kuvend;

2.11. Paraqet propozime dhe rekomandime në Kuvend;

2.12. Përcakton përdorimin e emrit dhe llogon e Federatës së badmintonit të Kosovës;

2.13. Përfaqëson Federatën e badmintonit të Kosovës në gjitha çështjet juridike përmes zyrtarëve të saj apo palëve të treta;

2.14. Merret me të gjitha çështjet që nuk i atribuohen shprehimisht një organi tjetër brenda BFK;

2.15. Miraton propozimin për marrjen e vendimit për paraqitjen e kandidaturës për organizimin egarave ndërkombëtare;

2.16. Sipas vlerësimit monitoron kuvendet zgjedhore të Anëtarëve të regjistruar në Federatën e badmintonit të Kosovës;

2.17. Bën monitorimin financiar dhe llogaridhënien financiare në baza mujore;

2.18. Zbaton aktet normative të Federatës së badmintonit të Kosovës dhe vendimet e Kuvendit;

2.19. Harmonizon planin financiar gjatë vitit në pajtim me rrethanat e ndryshuara;

2.20. Organizon procesin formal të formimit të Komisionit të Sportistëve prej tre (3) sportistëve të cilët funksionojnë në përputhje me Rregulloren përkatëse.

3. Bordi Ekzekutiv është organ ekzekutiv i Federatës së badmintonit të Kosovës dhe ka 9 (nëntë) anëtar në total.

4. Kryetari i Federatës së badmintonit të Kosovës me automatizëm është anëtar dhe kryetar i Bordit Ekzekutiv.

5. Kryesuesi i Komisionit të Sportistëve i cili zgjedhet nga votimi i sportistëve, me automatizëm është anëtar i Bordit ekzekutiv.

6. Shtatë (7) anëtarë të Bordit Ekzekutiv të Federatës së badmintonit të Kosovës i zgjedhë Kuvendi.

7. Nga shtatë (7) anëtarë të Bordit Ekzekutiv, Kryetari i propozon për miratim dy (2) kandidatë në Kuvend.
8. Në përbërjen e plotë të Bordit Ekzekutiv duhet të jenë të rezervuara së paku tri (3) pozita për gjininë femërore.
9. Bordi Ekzekutiv mblidhet të paktën gjashtë (6) herë në vit dhe poashtu kur thirret nga Kryetari ose me kërkesë specifike nga katër (4) anëtarë të Bordit Ekzekutiv në afat brenda shtatë (7) ditësh;
10. Kundër Vendimit të Bordit Ekzekutiv mund të bëhet ankesë në Komisionin e Apelit në afatin prej tredhjetë (30) ditëve nga dita e dorëzimit të vendimit. Ankesa e paraqitur nuk e pezullon ekzekutimin e Vendimit;
11. Me Rregulloren e punës së Bordit Ekzekutiv më detalisht përcaktohet mënyra e punës, të drejtat dhe përgjegjësitë dhe çështjet tjera me rëndësi për punën e Bordit Ekzekutiv

Neni 17

Kryetari

1. Përgjegjësitë e kryetarit të Federatës së badmintonit të Kosovës , janë:
 - 1.1. Kryetari i Federatës së badmintonit të Kosovës njëkohësisht është edhe kryetar i Bordit Ekzekutiv si dhe Udhëheqës i Kuvendit, i cili zgjedhet nga Kuvendi me vota të fshehta për afatin 4 (katër) vjeçar;
 - 1.2. Kryetari udhëheq mbledhjet e Kuvendit dhe të Bordit Ekzekutiv;
 - 1.3. Nënshkruan aktet e përgjithshme të cilat i miraton Kuvendi apo Bordi Ekzekutiv dhe përkujdeset për zbatimin e qendrimeve, vendimeve dhe rekomandimeve të Kuvendit dhe të Bordit Ekzekutiv;
 - 1.4. Kryetari duhet të sigurojë që Federata e badmintonit e Kosoves të mbaj marrëdhënie pozitive dhe produktive me anëtarësimin e saj të brendshëm dhe të jashtëm, mediat, sponsorët, donatorët, KOK, MKRS, BBA, BEC, BWF, organizatat e tjera dhe komunitetin e gjerë;
 - 1.5. Kryen aktivitete të caktuara me këtë Statut dhe me aktet tjera të Federatës së badmintonit të Kosovës ose aktivitete që lidhen me funksionin e Kryetarit;
 - 1.6. Kryetari për punën e tij i përgjigjet Kuvendit.
 - 1.7. Mandati kryetarit mund ti nderpritet edhe para kalimit të 4 (katër) viteve në rastet kur:
 - 1.7.1. Ndërron ose e humb shtetësinë;
 - 1.7.2. Dhënjes së dorëheqjes;
 - 1.7.3. Votimit të mosbesimit ndaj tij të miratuar nga Kuvendi apo të ndonjë situate që nuk

mund të vazhdojë më të kryej detyrën;

1.7.4. Nëse gjatë mandatit denohet me aktgjykim të formës së prerë për çfarëdo vepre penale.

1.8. Kryetari ka të drejtë të nominoj një anëtar të ri të çdo organi të Federatës së badmintonit të Kosovës të zgjedhur nga Kuvendi nëse në organin e njëjtë mbetet një pozitë e lirë vakante. Anëtar i ri i propozuar nga Kryetari do të ushtroj detyrat e tij/saj deri në Kuvendin e radhës.

1.9. Federata e badmintonit e Kosovës e ka një nënkryetarë të cilin e emëron Kryetari nga radhët e Bordit me afat 4 (katër) vite dhe të cilit i harton detyrat dhe përgjegjësitë.

1.10. Federata e badmintonit e Kosovës e përfaqëson Kryetari, e në mungesë të tij e përfaqëson Nënkryetari ose anëtar i më i vjetër në bordin ekzekutiv sipas radhës

1.11. Për pozitën e Kryetarit mund të kandidojë personi që plotëson kriteret në vijim:

1.11.1. Të jetë shtetas i Kosovës;

1.11.2. Preferohet të jetë veprimtar i dalluar i sportit të badmintonit me rezultate në organizimin dhe udhëheqjen e sportit;

1.11.3. Të ketë përgatitje superiore shkollore;

1.11.4. Preferohet të njohë një gjuhë botërore (përparësi i jepet gjuhës angleze);

1.11.5. Mos të ketë rënë në kundërshtim me normat etike dhe morale dhe me parimet e Lëvizjes dhe Kartës Olimpike dhe të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë për çfarëdo vepre penale.

1.12. Kandidatin për kryetar mund ta propozoj një Anëtar kur siguron paraprakisht pëlqimin meshkrim nga pesë (5) anëtarë të Kuvendit me të drejtë vote.

1.13. Kryetari i zgjedhur do të shërbejë për një mandat katër (4) vjeçar dhe do të ketë të drejtë përrizgjedhje edhe për dy mandate të njëpasnjëshëm në të njëjtin funksion;

1.14. Shkarkimi i kryetarit kryhet në mënyrën dhe sipas procedurave të caktuara për zgjedhjen e tij.

Neni 18

Komisioni Mbikëqyrës

1. Komisioni Mbikëqyrës është organ i Kuvendit me detyrë të:

1.1. Mbikëqyrë veprimtarinë e Federatës së badmintonit të Kosovës ;

1.2. Verifikojë ligjshmërinë në punë dhe afarizmin materialo-financiar të Federatës së badmintonit të Kosovës ;

- 1.3. Mbikëqyrë zbatimin e vendimeve dhe akteve normative të Kuvendit dhe të Bordit Ekzekutiv;
- 1.4. Identifikon rreziqet e mundshme dhe rekomandon planin për eliminimin e tyre;
- 1.5. Bënë verifikimin e ligjshmërisë së punës së Federatës së badmintonit të Kosovës me obligimet që dalin nga legjislacioni në fuqi por nuk kufizohet në: Ligjin për OJQ, Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Ligjin për Sport, Ligjin për Sponsorizimin.
2. Komisioni Mbikëqyrës i ka tre (3) anëtarë të cilët i zgjedh Kuvendi, ndërsa kryesues zgjedhet personi që merr më së shumti vota.
3. Shkarkimi i anëtarëve të Komisionit Mbikëqyrës e bën Kuvendi në procedurë të njëjtë sikurse zgjedhjen e tyre.
4. Çdo anëtar apo organ i Federatës së badmintonit të Kosovës duhet të bashkëpunoj me Komisionin Mbikëqyrës.
5. Raporti financiar vjetor verifikohet nga Komisioni Mbikëqyrës para se i njëjti të dërgohet në Kuvend për miratim.
6. Për pozitën e anëtarit të Komisionit Mbikëqyrës, anëtari i Federatës së badmintonit të Kosovës mund ta nominoj një person për anëtar të Komisionit Mbikëqyrës i cili plotëson kriteret në vijim:
 - 6.1. Të jetë shtetas i Kosovës;
 - 6.2. Të ketë përgatitje të lartë shkollore;
 - 6.3. Preferohet të kenë përvojë në fushën juridike apo ekonomike.
7. Mënyra e punës së Komisionit Mbikëqyrës përcaktohet me Rregulloren përkatëse të punës së Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 19

Pozitat vakante

1. Nëse Kryetari i Federatës së badmintonit të Kosovës jep dorëheqje ose nuk është në gjendje të vazhdojë më gjatë në detyrë, ai ose ajo do të zëvendësohet nga nënkryetari, i cili obligohet të organizojë zgjedhjet e jashtëzakonshme zgjedhore brenda afatit prej 30 ditësh.
2. Mandati i Kryetarit të zgjedhur pas zgjedhjeve të jashtëzakonshme do të jetë për aq kohë sa ka mbetur mandat nga Kryetari paraprak për të siguruar se zgjedhjet mbahen mbi bazën e ciklit olimpike.
3. Kryetari ka të drejtë të nominoj një anëtar të ri të çdo organi të Federatës së badmintonit të Kosovës të zgjedhur nga Kuvendi nëse në organin e njëjtë mbetet një pozitë e lirë vakante. Anëtari i ri i propozuar nga Kryetari do të ushtrojë detyrat e tij/saj deri në Kuvendin e radhës.

4. Mandati i anëtarëve të bordit është i lidhur me mandatin e Kryetarit.
5. Në rastin e kalimit të sukseshëm të mocionit të mosbesimit të organeve ekzekutive të Federatës së badmintonit të Kosovës, anëtarët e Kuvendit caktojnë një komision përgjegjës për organizimin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme brenda afatit prej 30 ditësh.

Neni 20

Komisionet

1. Komisionet vijuese i zgjedhë Kuvendi: Komisionin Mbikëqyrës, Komisionin Disiplinor, Komisionin e Apelit,
2. Komisioni i Sportistëve zgjedhet nga lojtarët.
3. Komisionet, Zyrtarët, grupet e punës dhe panelet mund të emërohen, si rregull, me detyrat dhe synimet e mëposhtme:
 - 1.1. Të merren me një ose më shumë aspekte të veçanta të aktiviteteve;
 - 1.2. Të këshillojë dhe ndihmojë Bordin Ekzekutiv dhe Sekretarin e Përgjithshëm për të gjitha çështjet praktike dhe organizative që lidhen me ato aspekte të veçanta të aktiviteteve, për të cilat ata janë përgjegjës.
4. Komisionet e mëposhtme emërohen nga Bordi Ekzekutiv:
 - 1.1. Komisioni për Marrdhënie Ndërkombëtare,
 - 1.2. Komisioni për Barazi Gjinore
 - 1.3. Komisioni për Personat me Aftësi të Kufizuara
 - 1.4. Komisioni i regjistrimit/ licencimit të klubeve sportistëve trajnerve,
 - 1.5. Komisioni i Garave,
 - 1.6. Komisioni për Marketing,
 - 1.7. Komisionin shëndetësor,
 - 1.8. Komisioni për Akte Normative,
 - 1.9. Komisioni Profesional dhe Zhvillimor.
 - 1.10. Komisioni i Gjyqtarëve,
 - 1.11. Komisioni i Trajnerëve
 - 1.12. Komisioni i Veteranëve

5. Bordi Ekzekutiv ka mandatin që të krijojë edhe komisione tjera nga ato të cekura në paragrafin 4 të këtij neni për arritjen e synimeve dhe objektivave të përgjithshme të Federatës së badmintonit të Kosovës .
6. Bordi Ekzekutiv mund të krijojë, shpërbëjë, bashkojë, pezullojë funksionimin dhe rregullojë në mënyra të tjera Komisionet dhe Grupet e Punës, kohë pas kohe, sipas rrethanave.
7. Numri i personave që shërbejnë si anëtarë në secilin Komision përcaktohet nga Bordi Ekzekutiv para emërimit të anëtarëve të Komisionit apo Komisionit përkatës.
8. Kryetari i secilit Komision do t'i paraqesin Bordit Ekzekutiv një raport vjetor të aktiviteteve, duke tërhequr vëmendjen për çdo rekomandim që Komisioni dëshiron të bëjë; pranimi i raportit nuk do të nënkuptojë automatikisht pranimin e rekomandimeve të tilla.

Neni 21

E drejta për kandidim

1. Nominimet e kandidimet për pozitat për: Kryetar, anëtarë të Bordit Ekzekutiv, Komisionit të Apelit, Komisionit Mbikqyrës, apo Komisionit Disiplinor mund të bëhen vetëm nga anëtarët e regjistruar në federatën e badmintonit të Kosovës.
2. Një anëtar mund të nominoj nga një kandidat për një organ të Federatës së badmintonit të Kosovës
3. Një Anëtar që nuk ka të drejtë vote nuk e ka as të drejtën e nominimit.
4. Një Anëtar që është dënuar ndonjëherë me aktgjykim të formës së prerë për çfarëdo vepre penale, nuk ka të drejtë të kandidohet për asnjë pozitë në kuadër të organeve të Federatës së badmintonit të Kosovës.
5. Kandidatët që aplikojnë për të qenë anëtarë të organeve të BFK-së duhet të mos bie ndesh me nenin 50, nenit 68 dhe 69 të ligjit për sportin.

Neni 22

Konflikti i interesit

1. Anëtarët e një organi të Federatës së badmintonit të Kosovës duhet të shmangin çdo situatë që mund të çojë në një konflikt interesi ose konflikt të perceptuar të interesit. Çdo konflikt aktual, i perceptuar ose i mundshëm i interesit duhet të deklarohet dhe individit duhet të ndërmarrë veprime për të hequr veten nga situata ku mund të lindë një konflikt. Është përgjegjësi personale e secilit person të shmangë çdo rast të konfliktit të interesit.
2. Anëtarët e Bordit përfshirë Kryetarin dhe Sekretarin e Përgjithshëm nuk mund të jenë njëkohësisht edhe Kryetar i klubit që është aktiv dhe anëtar në Federatën e badmintonit të Kosovës apo të jenë trajner të përfaqësuesës.
3. Anëtarët e Bordit Ekzekutiv, Bordit të Apelit, Komisionit Mbikqyrës, apo Komisionit Disiplinor nuk mund të jenë anëtarë edhe të ndonjë komisioni tjetër në të njëjtën kohë.

Neni 23

Kodi i etikës (Sjellja e duhur)

1. Të gjithë anëtarët e organeve vendimmarrëse të Federatës së badmintonit të Kosovës do t'i kryejnë detyrat në mënyrë të duhur dhe të pavarur, për interesat më të mira të badmintonit në Kosovë, pa marrë parasysh interesat e veçanta.
2. Federata e Badmintonit të Kosovës ka Rregulloren përkatëse për kodin etikës.

Kapitulli V - STRUKTURA ADMINISTRATIVE

Neni 24

Stafi menaxhues administrativ

1. Bordi Ekzekutiv emëron stafin menaxhues administrativ sipas kriterëve të përcaktuara nga Bordi Ekzekutiv dhe themelimi i marrëdhënies së punës bëhet në pajtim me Ligjin e Punës të Republikës së Kosovës, në fuqi.
2. Federata e badmintonit të Kosovës e ka Sekretarin e Përgjithshëm të cilin e zgjedh Bordi Ekzekutiv sipas procedurës së hapur të rekrutimit dhe i cili duhet të plotësoj kushtet dhe kriteret minimale të kandidimit dhe të pajtohet me detyrat dhe përgjegjësitë e publikuara sipas procedurës së hapur të rekrutimit të personelit nga Federata e badmintonit të Kosovës për një mandat katër (4) vjeçar me mundësi të vazhimit të mandatit apo ri-kandidimit dhe përzgjedhjes së sërishme.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretarit të Përgjithshëm, janë:
 - 3.1. Sigurimi i ligjshmërisë së punës dhe kryerja e obligimeve të përcaktuara ligjore, administrative, financiare dhe organizative të Federatës së badmintonit të Kosovës në mënyrë profesionale dhe sipas parimeve të kodit etik, duke përfshirë por duke mos u limituar edhe në funksionet në vijim:
 - 3.1.1. Është përgjegjës për përgatitjen me kohë të materialeve për mbledhjet e Kuvendit dhe mbledhjet e Bordit Ekzekutiv;
 - 3.1.2. Merr pjesë dhe ndihmon në mbarëvajtjen e të gjitha mbledhjeve të organeve, komisioneve të Federatës në cilësinë e këshilldhënësit apo anëtarit;
 - 3.1.3. Përgatit materialet, dokumentet dhe raportet e duhura për aplikim në procesin e kategorizimit;
 - 3.1.4. Përgatit materialet, dokumentet dhe raportet e duhura për dorëzim ose aplikim në

Departamentin të Sportit në MKRS me qëllim të raportimit dhe mbylljes e hapjes së kisteve kuartale;

3.1.5. Përkujdeset për zbatimin e vendimeve dhe rekomandimeve të Kuvendit dhe të Bordit Ekzekutiv;

3.1.6. Ekzekutimin dhe monitorimin e planit financiar të Federatës së badmintonit të Kosovës në bazë të kërkesave dhe vendimeve të Bordit Ekzekutiv;

3.1.7. Zbatimin e plan-programit ditor dhe planit strategjik të Federatës së badmintonit të Kosovës

3.1.8. Komunikimi dhe bashkëpunimi me MKRS, KOK, federatat tjera sportive dhe organizatat tjera ndërkombëtare sportive;

3.1.9. Sigurimi i transparencës dhe punës publike të Federatës së badmintonit të Kosovës ;

3.1.10. Mbikqyrja dhe përpilimi i rezultateve dhe ranglistave zyrtare;

4. Për punën dhe performancën e tij Sekretari i Përgjithshëm i përgjigjet Bordit Ekzekutiv i cili organ mund të ndërpresë mandatin e tij në raste të neglizhencës së lartë apo performancës së dobët që mund të ndikojë në mos arritjen e synimeve dhe objektivave të realizimit të planit të punës së Federatës së badmintonit të Kosovës .

Neni 25

Administrata

1. Korrespondenca, komunikimi, dokumentacioni dhe procedurat e Federates së badmintonit do të zhvillohen në gjuhën shqipe. Sipas kërkesës paraprake të miratuar nga organet e Federatës së badmintonit të Kosovës , administrata duhet të kujdeset të sigurojë përkthimin simultan të takimeve të Kuvendit në përputhje me Ligjin për përdorimin e gjuhëve në Republikën e Kosovës.
2. Duke qenë Federata e badmintonit anëtare e plotë në Asociacionin ballkanik të badmintonit (BBA) Federaten e badmintonit të Evropës (BEC) dhe Federatën botërore të badmintonit (BWF) obligohet administrata që Statuti i Federatës së badmintonit të Kosovës të përkthehet në gjuhën angleze dhe të përditësohet pas çdo ndryshimi dhe plotësimi të tij.
3. Kryerjen e disa punëve profesionale Bordi Ekzekutiv mund t'ia besojë ndonjë shërbimi tjetër profesional, organizate ose individ duke lidhur kontratë për detyra specifike.

Neni 26

Garat

1. Garat zyrtare në Kosovë mund të organizohen vetëm nga Federata, ose organi i autorizuar nga bordi i saj. Garat zhvillohen në bazë të rregullave të Federates së badmintonit të Kosovës dhe

rregulloreve të Federatës Evropiane të Badmintonit. Orarin e të gjitha garave dhe rregullave e miraton Bordi i Federates së badmintonit të Kosovës. Konform rregullores së garave të harmonizuar me federaten evropiane të badmintonit.

2. Federata e badmintonit e Kosovës ka rregulloren përkatëse për mbarrëvajtjen e garave;

Kapitulli VI - PËRFAQËSUESJA E KOSOVËS

Neni 27

Reprezentacionet

1. Me qëllim të përparimit dhe realizimit të arritjeve të rezultateve të larta në badminton si në arenën vendore apo ndërkombëtare, Federata e badmintonit e Kosovës formon ekipet e përfaqësueses së Kosovës në badminton (ne tekstine mëtejme: Përfaqësuesja) për të gjitha grupmoshat.
2. Udhëheqja e ekipit të Përfaqësueses së Kosovës është në kompetencë të Selektorit të Përfaqësueses së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Selektori për kategorinë e caktuar).
3. Në punën profesionale me ekipet e Përfaqësueses angazhohen edhe trajnerët e përfaqësuesve që arrin rezultate në nivel nacional dhe pjesmarje në gara ndërkombëtare aprovohen nga Bordi Ekzekutiv.
4. Ngjyrat e fanellave të reprezentacionit shtetëror të Badmintonit të Kosovës dhe detajet tjera vendosen nga komisioni profesional.
5. Me rregulloren e punës së ekipit të Përfaqësueses së Kosovës përcaktohet mënyra e veprimtarisë, të drejtat dhe obligimet, kushtet e punës së Selektorit, trajnerëve dhe anëtarëve tjerë të ekipit të Përfaqësueses.

Neni 28

Drejtori i përfaqësues së Kosovës

1. Federata ka Drejtorin e Përfaqësueses së Kosovës të cilin e zgjedh Bordi Ekzekutiv sipas konkursit publik.
2. Drejtori është i pavarur në punën e tij profesionale, ndërsa për punën dhe përgjegjësitë e tij/saj i përgjigjet Bordit Ekzekutiv.
3. Drejtori bën përzgjedhjen dhe përbërjen e sportistëve të Përfaqësueses për të gjitha grupmoshat si dhe bën përzgjedhjen dhe përbërjen e trajnerëve të Përfaqësueses duke u bazuar në kriteret meritore dhe profesionale të pasqyruara në Planin Profesional të Punës të Drejtorit të miratuar nga Bordi Ekzekutiv, për të siguruar një paraqitje sa më të suksesshme, etike, profesionale dhe dinjitoze të Përfaqësueses së Kosovës në ngjarjet dhe garat ndërkombëtare.

4. Drejtori me automatizëm është edhe kryesues i Komisionit të Trajnerëve të Federatës së badmintonit të Kosovës .
5. Drejtori, krahas planit profesional të punës, obligohet të dorëzojë raportin pas secilit përfaqësim ndërkombëtarë si dhe raportin vjetor të punës të cilat duhet të miratohen nga Bordi Ekzekutiv.
6. Një person për të kandiduar dhe për t’u emëruar Drejtor i Përfaqësueses së Kosovës duhet të plotësoj kushtet dhe kriteret minimale si në vijim:
 - 3.1. Të jetë veprimtar i dalluar sportit të badmintonit me rezultate kulminante në organizimin dhe udhëheqjen e sportit;
 - 3.2. Të ketë përgatitje superiore shkollore, preferohet fakulteti i edukatës fizike ose i çertifikuar në njërën nga nivelet formale të BWF për trajner;
 - 3.3. Të njeh një gjuhë botërore, përparësi i jepet gjuhës angleze;
 - 3.4. Mos të ketë rënë në kundërshtim me normat etike dhe morale dhe me parimet e Lëvizjes dhe Kartes Olimpike dhe të mos jetë i denuar me aktgjykim të formës së prerë për cfarëdo veprë penale.
7. Drejtori zgjidhet për një mandat katër (4) vjeçar me mundësi të ri-kandidimit dhe përzgjedhjes së sërishme.
8. Për të gjitha ekipet e përfaqësueses së Kosovës përcaktohen dhe angazhohen trajnerët përkatës.
9. Drejtori bën përzgjedhjen e trajnerëve të ekipeve Përfaqësuese bazuar në kriteret, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre të pasqyruara në Planin Profesional të Punës të Drejtorit dhe të miratuar nga Bordi Ekzekutiv.
10. Për punën e tij, trajneri i ekipit të Përfaqësues i përgjigjet Drejtorit.

Kapitulli VII - DISPOZITAT KONTRAKTUALE DHE FINANCIARE

Neni 29

Kontratrat dhe financimi

1. Bordi Ekzekutiv vendos varësisht nga rëndësia dhe vlera financiare e kontratës për autoritetin që do të bëjë nënshkrimin.
2. Për ekzekutimin e pagesave mbi vlerën 500 euro, kërkohet edhe autorizimi i Kryetarit ose Nënkyetarit të Bordit në mungesë të kryetarit.
3. Për çështje të njëjtë ndalohet financimi i dyfishtë nga burime të ndryshme të financimit sipas nenit 45 të ligji të sportit
4. Çdo pagesë mbi 300 euro bëhet përmes transaksionit bankar.

Neni 30

Dispozitat financiare

1. Viti financiar kalendarik i Federatës së badmintonit të Kosovës është nga 1 janari deri më 31 dhjetor. Llogaritë dhe raportet financiarembahen në Euro dhe menaxhohen në përputhje me kërkesat e standardeve të kontabilitetit të pranueshëm dhe të zbatueshëm në Kosovë dhe Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike të Kosovës.
2. Sekretari i Përgjithshëm obligohet që të përgatit raportin vjetor financiar, i cili kontrollohet nga Komisioni Mbikqyrës pas miratimit nga Bordi Ekzekutiv dhe i njëjti i paraqitet Kuvendit për shqyrtim dhe aprovim.
3. Raporti vjetor financiar, pas aprovimit nga Kuvendi duhet të auditohet nga një auditor i jashtëm i pavarur dhe të përfundohet deri më 31 mars të vitit pasues. Pasqyrat financiare dhe raportet e auditimit publikohen në faqen zyrtare të BFK-së.
4. Llogaria bankare e Federatës së badmintonit të Kosovës mbahet në bankën komerciale të aprovuar nga Bordi Ekzekutiv.
5. Fuqinë e nënshkrimit në llogarinë bankare të Federatës së badmintonit të Kosovës dhe paisja me kartelë bankare kufizohet për përdorim vetëm për Sekretarin i Përgjithshëm dhe Kryetarin.

Neni 31

Të ardhurat në Federatë

1. Federata financohet nëpërmes:
 - 1.1. Memorandumeve të lidhura në mes MKRS - BFK- së, Komiteti Olimpik, Federatës Evropiane dhe Federatës Botërore të Badmintonit,

- 1.2. Të hyrave nga organizimi i garave,
- 1.3. Anëtarësisë,
- 1.4. Marketingut,
- 1.5. Të tjera burime legale
- 1.6. Të hyrtat nga Sponzorizimi

Neni 32

Kontrolli i Brendshëm

1. Komisioni Mbikqyrës i ka të gjitha kompetencat për vlerësimin dhe monitorimin e brendshëm të Federatës së badmintonit të Kosovës për të siguruar ligjshmërinë e veprimtarisë të punës dhe zbatimin e akteve normative të Federatës së badmintonit të Kosovës.
2. Komisioni i paraqet Kuvendit një raport vjetor të aktiviteteve dhe rekomandimeve të tij..

Neni 33

Kuotizimi

1. Çdo Anëtar është i obliguar të kryejë me sukses pagesën vjetore për anëtarësim në Federatën e badmintonit të Kosovës siç përcaktohet nga Bordi Ekzekutiv..
2. Një Anëtarë i cili është dorëhequr apo pezulluar nga Kuvendi dhe i cili ka borje financiare apo asete nëshfrytëzim ndaj Federatës së badmintonit të Kosovës , është i obliguar ti kthejë ato më së largu 30 ditë nga momenti kur i është ndëprerë anëtarësimi në Federatën e badmintonit të Kosovës.

Kapitulli VIII – E DREJTA NE MJETET JURIDIKE

Neni 34

Organet vendimmarrëse

1. Organet e mëposhtme të Federatës së badmintonit të Kosovës kanë kompetenca vendimmarrëse:
 - 1.1. Kuvendi;
 - 1.2. Bordi Ekzekutiv;
 - 1.3. Komisioni Disiplinor;
 - 1.4. Komisioni i Apelit.

Neni 35

Rregullat procedurale të zbatueshme për organet vendimmarrëse

1. Organet vendimmarrëse të Federatës së badmintonit të Kosovës sigurojnë procedura të drejta për të gjitha palët e përfshira dhe dotë respektojnë të drejtat e tyre themelore. Ata njohin në mënyrë të veçantë:
 - 1.1. Që çdo person që vepron në Federatën e badmintonit të Kosovës nuk do të marrë pjesë në ndonjë bashkëveprim i cili mund të ndikojë në një përfundim ose vendim në lidhje me ndonjë çështje specifike nëse personi ka një konflikt interesi sipas Kodit të Etikës;
 - 1.2. E drejta e Anëtarit të Federatës së badmintonit të Kosovës të ketë qasje në dokumentacionin e Federatës së badmintonit të Kosovës dhe të ekzaminojë dosjen përkatëse;
 - 1.3. E drejta për t'u njoftuar me sanksionet apo gjobat që mund të shqiptohen;
 - 1.4. E drejta për t'u dëgjuar, për të paraqitur një mbrojtje, për të dëshmuar dhe për t'u ndihmuar nga mbrojtësit me shpenzimet e tyre;
 - 1.5. E drejta për të paraqitur ankesë në komisionin e Apelit.

Neni 36

Komisioni Disiplinor

1. Komisionin disiplinor e përbëjnë tre (3) anëtarë të cilët i zgjedh Kuvendi.
2. Anëtarët e Federatës së badmintonit të Kosovës përfshirë anëtarësinë e tyre përgjigjen para Komisionit Disiplinor nëse bien në kundërshtim me detyrat e përcaktuara me aktet normative të Federatës së badmintonit të Kosovës .
3. Kërkesën për nismën e procedurës disiplinore mund ta bëjë çdo anëtar i Kuvendit që përfaqëson një klub sportiv të badmintonit, anëtarët e Bordit Ekzekutiv, anëtarët e ekipeve përfaqësuese, anëtarët e Administratës, apo komisioneve.
4. Komisioni Disiplinor vepron duke u bazuar në Kodin Disiplinor të Federatës së badmintonit të Kosovës .
5. Kundër Vendimit të Komisionit Disiplinor mund të bëhet ankesa në Komisionin e Apelit në afatin prej pesëmbdhjetë (15) ditëve nga dita e dorëzimit të vendimit. Ankesa e paraqitur nuk e pezullon ekzekutimin e Vendimit.
6. Komisioni i apelit është i obliguar të zgjidh ankesën në afatin prej pesëmbdhjetë (15) ditësh nga dita e dorëzimit të vendimit.
7. Nëse anëtari, të cilit i është ndërprerë mandati para skadimit të afatit për të cilin është zgjedhur, ka qenë anëtar i Komisionit Disiplinor, zgjedhet një anëtar i ri nga ana e Kryetarit të Federatës së badmintonit të Kosovës , mandati i të cilit zgjat deri në Kuvendin e radhës.

Neni 37

Komisioni i i Apelit

1. Komisioni i apelit përbëhet nga tre (3) anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi. Anëtarët preferohet të kenë një arsimim juridik ose përvojë në çështjet juridike.
2. Vendimet e Komisionit të Apelit janë përfundimtare për çdo ankesë që paraqitet ndaj organeve vendimmarrëse të Federatës së badmintonit të Kosovës .
3. Një anëtar i Komisionit të Apelit nuk mund të mbajë e as të marrë një pozicion në organet e tjera juridike të Federatës së badmintonit të Kosovës .
4. Komisioni i Apelit vepron duke u bazuar në Rregulloren përkatëse të komisionit të Apelit.
5. Nëse anëtari, të cilit i është ndërprerë mandati para skadimit të afatit për të cilin është zgjedhur, ka qenë anëtar i Komisionit të Apelit, zgjedhet një anëtar i ri nga ana e Kryetarit të Federatës së badmintonit të Kosovës , mandati i të cilit zgjat deri në Kuvendin e radhës.

Neni 38

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve për Sport dhe Anti-doping

1. Në rast se ndonjë klub ose sportist konsideron se të drejtat e tij janë shkelur nga BFK edhe pas shfrytëzimit të të gjitha mjeteve juridike brenda BFK-së i njeiti ka të drejtë të ushtrojë ankesë në KAS në pajtim me nenin 64 dhe 66 të ligjit për sportin.

Kapitulli IX - TRASPARENCA DHE PUNA PUBLIKE

Neni 39

Transparenca dhe puna publike

1. Veprimtaria dhe puna e Federatës së badmintonit të Kosovës është transparente dhe publike.
2. Bordi Ekzekutiv harton dhe përpilon rregulloren për klasifikimin e informacioneve dhe obligohet Sekretari i Përgjithshëm të ofrojë transparencën, publikimin dhe qasjen e tyre sipas kësaj rregullore.
3. Bordi Ekzekutiv harton dhe përpilon rregulloren për mbrojtjen e të dhënave personale bazuar në Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe obligohet Sekretari i Përgjithshëm të aplikojë këtë rregullore.
4. Veprimtaria dhe puna publike e Federatës së badmintonit të Kosovës duke mos u limituar bëhet edhe përmes hapave në vijim:

- 4.1. Nëpërmjet dërgimit elektronik dhe me kohë të materialeve për shqyrtim, anëtarëve të organeve të Federatës së badmintonit të Kosovës dhe personave tjerë të ftuar apo të interesuar;
- 4.2. Nëpërmjet njoftimit përmes mjeteve të informimit, portaleve sociale, faqes së internetit të Federatës së badmintonit të Kosovës dhe mjeteve tjera komunikuese për organizimin dhe mbajtjen e takimeve, seminareve, aktiviteteve apo ngjarjeve tjera;
- 4.3. Informimit të komunitetit sportiv dhe qytetarëve për punën dhe afarizmin e Federatës së badmintonit të Kosovës ;
- 4.4. Publikimin e dokumenteve dhe informacioneve të ndryshme në faqen zyrtare të internetit të Federatës së badmintonit të Kosovës www.badminton-rks.org në përputhje me aktet normative të Federatës së badmintonit të Kosovës ;
- 4.5. Nëpërmjet konferencave për shtyp dhe forma tjera të komunikimit;
- 4.6. Dhe çdo forme tjetër të komunikimit apo publikimit që mund të bazohet në rekomandimet dhe praktikrat më të mira ndërkombëtare.

Kapitulli X - MIRËNJOHJET, SHPËRBLIMET DHE LAUREATËT

Neni 40

Mirënjohjet dhe shpërblimet

1. Federata e badmintonit e Kosovës ndan mirënjohje dhe shpërblime në shenjë të mirënjohjes për kontribut të veçantë ndaj njëindividit apo organizate në promovimin dhe zhvillimin e sportit të Badmintonit.
2. Me Rregulloren përkatëse për ndarjen e mirënjohjeve dhe shpërblimeve përcaktohen procedurat, kushtet, mënyra e propozimit dhe e miratimit të kandidatëve.

Neni 41

Lauretatët

1. Federata e badmintonit e Kosoves në baza vjetore shpall Laureatët e Vitit.
2. Bordi Ekzekutiv përcakton në bazë të mundësive buxhetore nivelin apo llojin e shpërblimit për tu ndarë Laureatëve të Vitit në Federatën e badmintonit të Kosovës.
3. Me Rregulloren përkatëse për zgjedhjen e më të mirëve përcaktohen procedurat, kushtet, dhe kriteret për përzgjedhjen e Lauretatëve të BFK-së.

Kapitulli XI - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 42

Shpërbërja

1. Për shpërbërjen e Federatës së badmintonit të Kosovës , nevojitet prezenca në Kuvend e më shumë se dy të tretave (2/3) e delegatëve me të drejte vote dhe kërkohet shumica e katër të pestave (4/5) të votave të hedhura PËR ose nëse numri i anëtarëve është më i vogël pak se pesë (5) të cilët veprojnë në së paku tri (3) qytete të ndryshme të Kosovës.
2. Në rast të shpërbërjes së Federatës së badmintonit të Kosovës, Kuvendi do të tregojë emrin e Federates/shoqatës ose fondacionit në Kosovë që do të marrë pasurinë e mbetur pasi të jenë paguar borxhet e organizatës. Shoqata(t) ose fondacioni(et) ezgjdhura duhet të kenë qëllime të njejta ose të ngjajshme sikurse organizata.

Neni 43

Dispozitat përfundimtare

1. Ndryshimet dhe plotësimet e Statutit bëhen në formë dhe sipas procedurave të parapara për aprovimine tij.
2. Të gjitha aktet normative të Federatës së badmintonit të Kosovës do të harmonizohen me këtë statut.

Neni 44

Hyrja në Fuqi

1. Ky statut u miratua nga kuvendi i përgjithshëm në Prishtinë më 26.03.2025 e i njeiti hynë në fuqi me datën e njejtë.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti shfuqizohet statuti i mëparshëm..

26.03.2025 Prishtinë

